

## Fëmijët në moshë të shkollës fillore

Fëmijët orientohen në atë, se çfarë kanë bashkëmoshatarët e tyre dhe me dëshirë duan të jenë si ata. Në përditshmëri ata përjetojnë gjatë blerjeve si dhe përmes reklamave gjithçka që ata mund të posedonin.

Fëmijën duhet të mësojnë si ta përdorin paranë – për këtë ata kanë nevojë për përkrahjen e të rriturve. Ata duhet të mësojnë se si ta ndajnë paranë e tyre, si të planifikojnë dhe të vendosin prioritetet. Një mundësi të mirë se si këto gjëra të ushtrohen, ofron paraja e xhepit.

### Paraja e xhepit

I ofron fëmijut tuaj rastin se si nga «buxheti» i tij i vogël të ushtrojë përdorimin e parasë. Paratë e xhepit janë të parapara për harxhime personale (sheqerka, revista etj.). Paraja e xhepit rekomandohet, sapo fëmija të fillojë interesohet për paranë, zakonisht me fillimin e shkollës.

### Disa këshilla:

- Bisedoni me fëmijën tuaj për përdorimin korrekt të parasë, megjithatë fëmijut i lejohej ta përdorë i lirë paranë e xhepit.
- Jepni paratë e xhepit rregullisht.
- Mos e lidhni paranë e xhepit me kushte tjera (mos i paguani fëmijët që ata të jenë të sjellshëm!)
- Mos jepni para shtesë, nëse paratë e xhepit nuk mjaftojnë. Ndoshta fëmija ka më shumë ide se si mundet ai vet të vijë te më shumë para (p.sh. të gjejë punë gjatë pushimeve).
- Tregoni fëmijës se si të ketë mbikqyrje mbi paranë p.sh me një «derrkuc» kursimi.
- Rregullat familjare vlejné edhe në lidhje me paratë e xhepit (p.sh. nuk ka ëmbëlsira para drekës/darkës edhe nëse fëmiju i ka blerë me paratë e tij të xhepit).

### Udhëzime për para xhepi (Këshillimoret për buxhet në Zvicër):

Prej vitit të parë deri në atë të katërt:  
për çdo javë

Viti i 1-rë shkollor nga CHF 1.-  
Viti i 2-rë shkollor nga CHF 2.-  
Viti i 3-rë shkollor nga CHF 3.-  
Viti i 4-rë shkollor nga CHF 4.-

Prej vitit të pestë:  
për çdo muaj

Viti 5./6. shkollor CHF 25.- deri CHF 30.-  
Viti 7./8. shkollor CHF 30.- deri CHF 40.-  
Viti 9./10. shkollor CHF 40.- deri CHF 50.-  
Nga Viti i 11 shkollor CHF 50.- deri CHF 80.-

Shuma e parasë së xhepit bazohet nga mundësitë financiare të familjes. Paraja e xhepit është një mundësi e mirë, por jo e vetmja mundësi për fëmijët, që ata të mësohen se si ta përdorin paranë. Është e rëndësishme që fëmijët të mund të bëjnë përvojat e tyre.

### Informata të tjera:

[www.projuventute.ch](http://www.projuventute.ch)  
[www.schulden.ch](http://www.schulden.ch)  
[www.budgetberatung.ch](http://www.budgetberatung.ch)  
[www.elternbildung.ch](http://www.elternbildung.ch)  
[www.caritas-schuldenberatung.ch](http://www.caritas-schuldenberatung.ch)

### Për fëmijë dhe të rinj:

[www.147.ch](http://www.147.ch)